



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 316 Prot.

Tiranë, më datë 26. 07. 2024

VENDIM
Nr. 275, datë 26.07.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 26.07.2024:

VENDOSI:

- Miratimin në parim të koncept idesë për projektin “Ndërtim i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” dhe parkim nëntokësor”, në qytetin e Beratit, me aplikues Znj. Meleqe Spahiu dhe zhvillues **Bashkia Berat me rekomandimet:**
 - Të sillen 2 variante duke e rishikuar projektin në raport me vëllimin dhe kontekstin ku ndodhet;
 - Variantet e propozuara të eliminojnë katin përdhe dedikuar për shërbime;
 - Të plotësohet raporti i ndikimit në trashëgiminë kulturore sipas manualeve të ICOMOS dhe UNESCO-s.
- Pas plotësimit të rekomandimeve të mësipërme të KKTKM, projekti do të përcillet pranë UNESCO për mendim;
- Ndjekja periodike ditore e punimeve të realizohet nga specialistët e Drejtorisë së Shërbimit Arkeologjik të IKTK-së në bashkëpunim me specialistët e DRTK Berat;
- Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

